



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1976, datë 14.06.2012

Për

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1863, datë 10.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 14.06..2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1863, datë 10.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.”

të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projekt Akti**);

- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi nr. 1863, datë 10.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.”;
- Shkresën nr. 813Prot. i AKEP, datë 25.4.2012, “Shpjegimet e shoqërisë Abissnet sh.a., lidhur me mosmarrëveshjen e interkoneksionit me Eagle Mobile sh.a.”;
- Shkresën e Eagle Mobile sh.a., me nr. 973Prot, datë 30.4.2012, (nr. 853Prot., datë 30.4.2012), “Pretendimet me shkrim mbi procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit me Abissnet sh.a.”, si edhe
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 1863, datë 10.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:

- *“Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.”;*
- *Të njoftohen palët e interesuara sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a për fillimin e procedimit administrativ;*
- *Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit”;*

II. Nga Abissnet sh.a., janë sjellë pretendimet me shkresën nr. 813Prot. i AKEP, datë 25.4.2012, *“Shpjegimet e shoqërisë Abissnet sh.a., lidhur me mosmarrëveshjen e interkoneksionit me Eagle Mobile sh.a.”* ku sqaron si më poshtë:

Abissnet sh.a., i është drejtuar AKEP që me autoritetin e tij të ndërhyjë duke vendosur ndryshimin e ORI dhe MI me Eagle Mobile sh.a., për arsye:

- 1- Tarifa e instalimit për çdo sistem E1 prej 136 000 Lekë është e papranueshme nga Abissnet sh.a.. (Aneksi II, pika 2.4 e draft marrëveshjes se interkoneksionit).
- 2- Vlera e kamatvonesës prej 0.5 % për çdo ditë kalendarike, që kërkon të aplikojë Eagle Mobile sh.a., në rast vonese të kryerjes së pagesave nga pala debitore, është 15 herë më e lartë se interesat bankare që zbatojnë bankat e nivelit të dytë në R.SH. (Aneksi III i draft MI).

Shkaqet e dhe arsyet e mosmarrëveshjes së interkoneksionit:

- *Tarifa e instalimit fillestar për çdo sistem E1 prej 136 000 Lekë është e papranueshme nga Abissnet sepse:*

Qarku E1, që bën të mundur realizimin e interkoneksionit të drejtpërdrejtë do të ndërtohet nga shoqëria Abissnet sh.a., duke përballuar vet të gjithë koston e ndërtimit dhe të punës për realizimin e këtij qarku. Edhe koston mujore të mirëmbajtjes së këtij qarku, Abissnet do ta paguaj vetë (300 euro/muaj);

Eagle Mobile sh.a., për realizimin e interkoneksionit të drejtpërdrejtë do të vendosë vetëm një portë në centralin e saj. Një portë e njëjtë do të vendoset edhe në centralin e Abissnet, dhe për vendosjen e saj Eagle Mobile nuk do të tarifohet nga Abissnet.

Interkoneksioni i drejtpërdrejtë midis Abissnet dhe Eagle Mobile, është interkoneksioni i bashkëvendosur, është Abissnet që me infrastrukturën e vet shkon tek Eagle Mobile, dhe ky i fundit nuk do të kryejë asnjë punim dhe nuk do të përballojë asnjë kosto për qarkun E1.

Abissnet ka lidhur marrëveshje interkoneksioni me Vodafone Albania dhe AMC. Për instalimin e qarkut E1 nuk është paguar asnjë kosto nga Abissnet, se qarku E1 është ndërtuar nga Abissnet dhe interkoneksioni është i bashkëvendosur. Qarku E1, i ndërtuar nga Abissnet për realizimin e interkoneksionit të drejtpërdrejtë do të përdoret edhe nga Eagle Mobile, dhe kjo e fundit nuk do të paguajë asnjë kosto instalimi apo qira mujore për përdorimin e këtij qarku.

Fakti që kjo kosto instalimi është pranuar nga operatorë të tjerë nuk përbën shkak që të pranohet edhe nga Abissnet. Secila palë kontraktore është e lirë të zgjedhë vetë mjetet dhe mënyrën për mbrojtjen e interesave, kjo nuk përbën shkak që edhe palët e tjera, në rastin konkret Abissnet, të heqin dorë nga mbrojtja e të drejtave të tyre dhe interesave të ligjshme, aq më tepër po të merren parasysh arsyet e lartpërmendura.

Zbatimi i tarifës së mësipërme e vendos Abissnet në pozita të diskriminuuese dhe bie në kundërshtim me nenin 39, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

2. *Vlera e kamatvonesës prej 0.5% për çdo ditë kalendarike vonesë të palës debitore është e papranueshme nga Abissnet, për keto arsye:*

Vlera e kamatvonesës prej 0.5%, që kërkon të aplikojë Eagle Mobile është rreth 15 herë me e lartë se interesat bankare që zbatohen bankat e nivelit të dytë në R.SH, për kreditë që japin me qëllim përdorimin e tyre për kapital qarkullues, interesi i të cilave shkon 7-10% në vit, ndërkohë sipas parashikimit të Eagle Mobile, kërkohet të aplikohet kamatvonesa në vlerën 5% në 10 ditë.

Kjo vlerë kamatvonesë është në kundërshtim edhe me Vendimin Unifikues nr. 932, datë 22.6.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku përcaktohet qartë: “...*Liria e kontraktimit nuk është absolute. Ajo gjithësesi mund të kufizohet nga faktorë ekonomikë e moralë. Injorimi i faktorëve të mësipërm çon në mungesë proporcionaliteti dhe në dëmtim të shpërpjestuar të interesave të palës kontraktuese, gjë që nënkupton që vullneti (pëlqimi) i kësaj pale nuk ka qenë krejt i lirë*”.

Në përfundim, Abissnet sh.a., bazuar në aryetimet e mësipërme i kërkon AKEP, që me autoritetin e tij të vendosë:

- Ndryshimin e ORI dhe draft marrëveshjes së interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a., duke vendosur moszbatimin e tarifës fillestare të instalimit për çdo sistem E1 prej 136 000 Lekë nga Eagle Mobile sh.a., dhe
- mosaplikimin e një kamatvonesë në 0.5%, për çdo ditë kalendarike vonesë të palës debitore.

III. Gjithashtu, Komisioni vëren se, nga Eagle Mobile sh.a., nuk janë sjellë pretendime në zbatim të VKD nr. nr. 1863, datë 10.4.2012.

Eagle Mobile sh.a., me shkresën nr. 973Prot, datë 30.4.2012, (nr. 853Prot., datë 30.4.2012), ka sjellë “*Pretendimet me shkrim mbi procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit me Abissnet sh.a.*” si më poshtë:

Eagle Mobile, në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi për të lidhur brenda afateve të përcaktuara MI mes palëve, i ka dërguar Abissnet në rrugë elektronike draft MI e re.

Abissnet, nuk e ka pranuar këtë draft duke ngritur pretendimet në lidhje me tarifën e instalimit për çdo sistem 2 Mbits, si edhe kamatvonesën prej 0.5%.

- Në lidhje me pretendimin për tarifën e instalimit për çdo sistem 2 Mbits, në vlerën 136 000 Lekë, sqarojmë se tarifa është përcaktuar në zbatim të ORI. Konkretisht ORI në Aneksin II “Shërbimet dhe tarifat e interkoneksionit”, pika 2.4.3, janë përcaktuar tarifat e shërbimeve të rrjetit të Eagle Mobile. Shërbimi 001, është shërbimi i bashkëvendosjes për vendosjen e pajisjeve të interkoneksionit në ambientet e Eagle Mobile. Ky shërbim tarifohet vetëm një herë për instalimin për çdo sistem 2 Mbits në shumën 136 000 Lekë.

Pretendimi i Abissnet, se ky shërbim nuk është i parashikuar në ORI të Eagle Mobile, nuk qëndron, pasi në ORI janë të parashikuara 2.4.3, shërbimi 001.

Gjithashtu, pretendimi i Abissnet se ai do të ndërtojë qarkun E1, nuk ka lidhje me këtë shërbim, por me shërbimet 107 dhe 108, pika 2.3.1, të ORI të Eagle Mobile, shërbime të cilat Abissnet nuk do të tarifohet nga Eagle Mobile.

Theksojmë se tarifa 136 000 Lekë, objekt mosmarrëveshje për lidhjen e MI mes paleve është tarifë e cila paguhet vetëm një herë dhe për vendosjen e pajisjeve të interkoneksionit të operatorit përfitues.

Në zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes palëve i kërkojmë AKEP të marrë në konsideratë kostot administrative, operacionale e të tjera, që Eagle Mobile duhet të përballojë në rastin e vendosjes së pajisjeve të operatorit përfitues në ambientet e Eagle Mobile, për të cilat mendojmë se tarifa prej 136 000 Lekë e cila paguhet vetëm njëherë është e justifikuar dhe e përfshirë në RIO. Kjo tarifë është pranuar nga të gjithë operatorët alternativë me të cilët Eagle Mobile ka lidhur MI, të cilët kanë qenë në të njëjtat kushte si Abissnet, për sa i përket lidhjes së interkoneksionit.

- Për kërkesën e dytë, sa i takon aplikimit të kamatvonesës nga Eagle Mobile, prej 0.5%, për çdo ditë kalendarike në rast vonese pagesash nga pala debitore, sipas Aneksit III, pikës 3.7, Sanksionet, i referohemi vendimit nr. 1699, datë 20.10.2011, të AKEP, që ka hedhur poshtë këtë pretendim të Abissnet, me arsyetimin se kjo kamatvonesë është përcaktuar në RIO-t e operatorëve celularë me të cilët Abissnet ka lidhur MI.

Në përfundim Eagle Mobile, në zbatim të ligjit nr. 9918; ligjit nr. 8485, K.Pr.A; nenit 99 e vijues të “Rregullores së aksesit dhe interkoneksionit”; nenit 15, të “Rregullores për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, kërkon nga AKEP:

Rrëzimin e pretendimeve të Abissnet në lidhje me tarifën e instalimit prej 136 000 Lekë dhe aplikimin e kamatvonesës prej 0.5 %, si dhe mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1863, datë 10.4.2012.

IV. AKEP, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet sa më sipër, gjykon se:

- Për pretendimin për tarifën e instalimit të vendosur nga Eagle Mobile sh.a., për çdo sistem E1 prej 136 000 Lekë AKEP, vlerëson se:
 - o Forma e interkoneksionit e rënë dakort midis palëve është ajo e bashkëvendosjes në ambientet e Eagle Mobile dhe Abissnet shkon me mjetet e tij deri në pikën e Interkoneksionit të EM. Qarku i interkoneksioni është për përdorim të përbashkët nga të dy palët për trafikun e shkëmbyer midis tyre;

- EM argumenton se tarifa 136 000 lek është për bashkvendosje por njëkohësisht e shpreh në terma të E1. Kjo tarifë e shprehur në këtë mënyrë konsiderohet si tarifë instalimi për cdo E1 dhe normalisht duhet të ishte pjesë e shërbimit 107 dhe 108. Për këto shërbime për formën e interkoneksionit bashkvendosur në anën e EM, operatori përfitues nuk paguan për portat E1 që i vë në dispozicion EM.
 - Në RIO dhe MI me dy operatorët e tjerë celularë AMC dhe Vodafone Albania operatorët përfitues paguajnë tarifa periodike për ambinetet me qira, por jo pagese fillestare one-off për vendosjen e pajisjeve.
 - Për sa më sipër si dhe duke u bazuar në praktikën e mëparshme, ku operatorët përfitues nuk kanë paguar tarifa one-off për instalimin e E1 për interkoneksionin e bashkvendosur, Abissnet nuk duhet të detyrohet nga EM të paguajë tarifën 136000 lek për E1.
- Për pretendimin e Abissnet sh.a., në lidhje me aplikimin e kamatvonesës nga Eagle Mobile sh.a., prej 0,5 % për cdo dite kalendarike që tejkalohet afati për pagesat AKEP, vlerëson se ky përcaktim ka qënë edhe më parë në marrëveshjet e interkoneksionit midis operatorëve në Shqipëri dhe është i njëjtë edhe me kamatvonesën e përcaktuar në ofertat referencë të operatorëve celularë me të cilët Abissnet sh.a., ka nënshkruar marrëveshje interkoneksioni (p.sh. MI e lidhur me AMC sh.a., Aneksi III, pika 3.7 Sanksionet, pika 3.7.1, fq. 52) .

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1863, datë 10.4.2012, *“Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.”*.
2. Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a të lidhin marrëveshje Interkoneksioni:
 - a. Duke mospërfshirë pagesën 136 000 lek/E1
 - b. Duke përfshirë kamatvonesën sic është në RIO të EM.
3. Të njoftohen palët e interesuara Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.për mbylljen e procedimit administrativ;

4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**